



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. _____/25
Kaçanik, 16.05.2025

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 26.05.2025 (e hënë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të KPF-s të datës 26.05.2025, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2025;
3. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-8206/25
Kaçanik, 23.04.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23.04.2025, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha.

Nga Ekzekutivi i Komunës, pjesëmarrës: Nënkrjetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Qamil Stagova-DUKMM, Bahri Selimi-DBF, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Suad Dullovi-DBPZHR, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, ndërkaq nga zyrtarët, në kuadër të detyrave të punës ishin: Mavije Murseli, Makfire Malsiu.

Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj: Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të KPF-së për vitin 2025, data 23.04.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
3. Raporti Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025;
4. Projekt-Rregullore Nr. XX për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut;
5. Draft-Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa komunale;
6. Propozim-Vendim Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2025 të datës 25.03.2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-5876/25.

2. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini, DBF zakonisht e sjellë Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka në këtë raport, lë të urdhëroj:

z. Agim Mani: Mirë është mos me pasur rekomandime të tilla nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ndërkaq zbatimin e këtyre rekomandimeve është mirë me u realizuar në kohë, në mënyrë që të njëjtat mos me u përsëritur. Ne kemi raste ku kemi pasur të njëjtin rekomandim në vitin 2023 i cili është përsëritur edhe në vitin 2024. Tani shkruan që rekomandimi është pjesërisht i zbatueshëm. Kryetari nuk është këtu, ndërkaq me intereson me ditur: Çka nënkupton pasuesi “pjesërisht i zbatuar”? Nëse një pjesë e këtij rekomandimi nuk zbatohet ai rekomandim është i pazbatuar. Unë këtë kërkesë për sqarim e kisha, e diskutojmë këtë çështje në mbledhje të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Të çështja e rekomandimit pjesërisht i zbatuar, është fjala se rekomandimi ka filluar me u zbatuar. Ky term përdoret për ato rekomandime që janë në zbatim e sipër. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky raport të shkojë në procedurë të KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se, **KPF shqyrtoj Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Ky Raport i procedohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.**

3. Raporti Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka rreth raporti, lë të urdhëroj:

z. Agim Mani: Në këtë raport nuk është përfshirë buxheti final. Cila është arsyeja që nuk janë përfshirë në raport të hyrat vetanake të bartura nga vitet paraprake? Shqetësuese është fakti i inksimit të mjeteve buxhetore dhe i shpenzimeve komunale, se janë në shumë të vogël, krahasuar periudhën 3 mujore apo ¼ e vitit buxhetor. Të pozicioni mallrat dhe shërbime, janë shpenzuar shumë mjete të mirëmbajtja e rrugëve. Gjithashtu kemi shumë shpenzime sipas vendimeve të gjykatës. Janë diku 2,011.34€ që janë paguar nga Mallrat dhe shërbimet, ndërkaq nga kategoria e Investimeve kapitale 320,462.60€. A janë 279,434.57€ shpenzime të ekzekutuara nga thesari në bazë të kontratës kolektive në arsim, apo janë me pak?

z. Bahri Selimi: Shuma e përgjithshme e shpenzimeve në bazë të vendimeve të gjykatave, është: 320,462.60€. Në arsim, në bazë të kontratës kolektive, shpenzimet e ekzekutuara nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore, janë 279,434.57€. Ka edhe me

tepër, por deri me 31 mars 2025, është ky realizim. Bartja e mjeteve buxhetore nuk ka ndodhur ende. Sivjet ndryshon procedura nga viti i kaluar i bartjes së mjeteve nga të HVK, nuk bartën në mënyrë automatike, se e kanë vlerësuar edhe MF se nuk është në rregull kjo formë, se iu ka krijuar problem komunave në ekzekutim të mjeteve buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit: Bartja e të HVK, ka me qenë si me herët, me vendime të KK.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Bartja e të HVK në formë automatike, ishte si test, se mos është formë me e mirë.

z. Bahri Selimi: Bartja e mjeteve sivjet bëhet si me herët, me vendime të KK, dhe mirë që e kanë vlerësuar se nuk ka qenë në rregull bartja në formë automatike. Në mbledhjen pasuese të KK sigurisht do të kemi bartje të mjeteve me vendim të KK.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pyetje për drejtorin: Te të HVK, ka qenë kërkesë e kahershme të bëhet ndarja e tyre të pozicioni, “Taksat tjera”, mirëpo kjo veç po përsëritet, ndarja e tyre se nga inkasohen këto mjete, nuk po ndodhë. Të Shpenzimet, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, në pjesën rurale në Kaçanik, janë 60 mijë euro të shpenzuara. Çka është punuar që është shpenzuar kjo shumë e mjeteve buxhetore, në cilat pjesë është bërë ky investim, se në raport mungojnë të dhënat për të dyja, për shpenzimet edhe të hyrat?

z. Qamil Stagova: Kur t’i dorëzohet prokurimit lënda, i dorëzohet edhe paramasa e punëve që përshinë si shpenzim.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në raport mundet me u shtuar edhe një tabelë, me u paraqitur se ku janë shpenzuar ato mjete në këtë periudhë kohore.

z. Bahri Selimi: Ka mundësi, se nuk e di saktë, që janë marrë mjetet edhe për shpenzime të gjykatave, sepse janë marrë mjetet nga projektet. Të IK sivjet janë ekzekutuar, 320,462.60€, është në fagen e fundit. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve është 478,188,72€ në total, nga këto mjete për vendime të gjykatave, janë marrë mjete në shumë 320,462.60€. Kjo si shpenzim ka ndodhë, ndërkaq ka mundësi të mos jetë kryer asnjë rrugë, por shpenzimi ekziston, se janë marrë mjetet të ai kod buxhetor.

z. Agim Mani: Duhet me u specifikuar këto shpenzime, sepse shpenzimet në bazë të vendimeve të gjykatave, nuk mundeni me quajtur shpenzime për investime kapitale.

z. Bahri Selimi: Nuk besoj, por ka mundësi, sepse nëpër kode tjera buxhetore, si ndërtimi i aneksit të shkollës” Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka’ janë shpenzuar 200 mijë euro apo 100% e mjeteve për zbatimin e kontratës kolektive. Ne këtu kemi treguar për secilën kategori sa mjete janë marrë, por nuk kemi treguar projektin që janë marrë, duke menduar se është informatë e mjaftueshme, por kemi treguar kategorinë ekonomike, Nga Mallrat dhe shërbime 2,011.34€, nga Investimet kapitale, 320,462.60€. Ne jemi atakuar me këtë problem, vjet për vjet na i kanë marrë mjetet, sivjet pritet me u përmbyllur. Deri me tani shpenzimet në bazë të vendimeve të gjykatave, e kanë kaluar shumën 500 mijë euro.

z. Rrustem Zenuni: A keni pasur drejtor deri me tani ndonjë komunikim me MEF, me na lehtësuar këtë barrë, për çështjen e mbulimit të shpenzimeve sipas kontratës kolektive në arsim, e cila pa të drejtë iu ka ngarkuar komunave?

z. Bahri Selimi: Nuk ka asgjë në këtë drejtim. Krejt komunat janë duke i mbuluar këto shpenzime me buxhetet e tyre.

znj. Ardita Rrahmani: Kam një pyetje, çka ka ndodhur drejtor me mëditjet e mbledhjeve të KPF?

z. Bahri Selimi: Për shtesat në përgjithësi janë duke pasur problem në ekzekutim edhe të policia e Kosovës, disa komuna nuk i kanë marrë shtesat as për shëndetësi e as për zjarrfikës. Të komuna jonë, vetëm të kuvendi nuk janë mjetet e mjaftueshme. Kur është miratuar në vitin e kaluar buxheti i vitit 2025, për paga dhe mëditje në Qarkore dhe dokumente tjera, nuk është paraparë shuma 55€ ngritje nga 1 janar-30 qershor, dhe ngritja tjetër nga muaji korrik prej 55€. Krejt shuma e ngritjes për 821 punëtorë, 831 mijë euro diku është shuma e ngritjes, kosto shtesë e pa planifikuar. Ne i kemi dërguar email ministrisë, pritet me u bërë një zgjidhje, për momentin nuk ka zgjidhje.

z. Agim Mani: Nuk është e planifikuar, se nuk është me Qarkore buxhetore. Ministria e merr tani një vendim.

z. Bahri Selimi: Mirë që kanë ndodhur rritjet, por kompensimin shtesë, muaj për muaj duhet me kompensuar ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi për rritjen e koeficientit për 0.5 nga 1 janari deri në korrik dhe prej korrikut- dhjetor me 0.5 e rrisin një kosto të buxhetit të pagave dhe mëditjeve në komunë. Buxheti i miratuar është me 30 shtator 2024, ndërkaq ngritja ka ndodhë pas miratimit të buxhetit. Vendimin e ka marrë ministria, ndërkaq kompensimi është dashur të bëhet nga GQ apo në ndonjë formë tjetër. Në kuadër të totalit të numrit të punësuarve 821 punëtorë, kanë pësuar vetëm anëtarët e KK që nuk i kanë marrë mëditjet. Çështja është që mos të ndodhë edhe muajin tjetër, përsëri me u dëmtuar anëtarët e KK, ndërkaq rritjen me marrë të tjerët.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse nuk na i procedojnë mjetet në muajin prill, ky trend vazhdon edhe muajin tjetër.

z. Bahri Selimi: Ne jemi të shqetësuar dhe jemi duke e analizuar këtë çështje, por çështja është se prej ministrit nuk kemi asgjë në këtë drejtim. Ndoshta edhe kjo hapësira e krijuar është në pyetje se a janë apo nuk janë ministra.

Kryesuesi i Kuvendit: Si do që të jetë, ne nuk mundemi me mbetur pa paga. Drejtori i thesarit dhe ai i buxhetit janë në detyrë dhe kanë kompetencë ekzekutive. Është mirë me pasur parasysh këtë çështje, që me iu dalë mjetet në mënyrë retroaktive.

z. Bahri Selimi: Edhe komunat tjera e kanë të njëjtin problem.

znj. Ardita Rrahmani: E vërtetë se edhe komunat tjera kanë problem për shtesat, ndërkaq ata të ministrisë, kam informacion se i kanë marrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur të bëhet një zgjidhje, besoj se bëhet për të gjithë, por ne është mirë me i pasur të dhënat e sakta për cilindo që nuk iu kanë paguar shtesat. Diskutime të tjera nuk ka. A jeni që raporti të shkoj në KK për trajtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se **KPF, Diskutoj Raportin Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025. Ky raport i kalon Kuvendit të komunës, në procedurë për shqyrtim.**

4. Projekt-Rregullore Nr. XX për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e hapi diskutimin:

znj. Dardana Tafili-Dauti: Këtë rregullore e ka hartuar një komision i formuar me vendim të kryetarit të komunës, i cili komision ka punuar bukur shumë në këtë drejtim. Rregullorja ka të bëjë me krejt zyrtarët e administratës komunale, varësisht prej vlerësimeve, kualifikimeve që kanë, ata e kanë pa të arsyeshme me i vendosur në këto pozita që janë sistemuar. Besoj se i keni pa se qysh i kanë vendosur mbi cilën bazë, nga profesional 3, në profesional 2 apo profesional 1, apo specialistë qysh janë të kategorizuar me ligjin për paga.

z. Rustem Zenuni: Është hera e parë që një rregullore e tillë vjen në KK.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Po, kjo rregullore është për herë të parë.

Kryesuesi i Kuvendit: Sistematizimi i vendeve të punës për punëtorët që punojnë deri tani, edhe me herët është bërë në bazë të ndonjë rregulloreje.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Ky sistematizim është me ligjin e ri që ka hyrë në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit: Me ligjin e ri është i pari ky sistematizim, ndërkaq sistematizim ka pasur edhe me herët. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që kjo çështje të shkoj në KK për trajtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

APROVOJ

Projekt-Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut. Kjo draft rregullore i, Rekomandohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Draft-Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: materialin e keni marrë, në rregullore janë paraparë të gjitha taksat që i vjelë komuna. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: E kam një propozim, po e jap tani që me pasur kohë edhe GP me diskutuar në mes veti, shpresoj se do të kaloj. Kërkesa ime ka të bëjë me lirimin nga taksat të përcaktuara në nenin 7, janë të përcaktuara kategoritë që lirohen nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare. Kërkoj me u liruar nga këto taksa, policia dhe FSK. Nuk jam e saktë, po janë diku 60 zyrtarë policor nga komuna e Kaçanikut, ndërkaq për FSK nuk e di numrin sa janë, mundem me u interesuar për numrin e këtyre kategorive.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Duhet pasur parasysh që ka policë nga komuna Hani i Elezit apo e Ferizajt që punojnë në Komunën e Kaçanikut. Tjetra, po ekziston mundësia për nxjerrjen e certifikatave nga sistemi e-Kosova.

znj. Ardita Rrahmani: Fjalën e kam për policët dhe FSK që punojnë në këto institucione, që janë nga komuna e Kaçanikut. Për informata me të hollësishme, përgatitem për mbledhje të KK.

z. Qamil Stagova: Ka zyrtar policor apo të FSK që e kanë ndërruar vendbanimin, ndërkaq janë nga komuna e Kaçanikut, edhe ata duhet me i liruar nga këto taksa komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Kategoritë që janë të liruara nga këto taksa komunale, janë të liruara në krejt Kosovën, dhe kjo është bërë si një lloj shpërblese për kontributin e tyre që

e kanë dhënë në periudha të caktuara. Policia e Kosovës dhe FSK mundet me u trajtuar si çdo zyrtar tjetër publik, për arsye se janë në shërbim të popullit, marrin paga nga shteti, se krejt kryejnë shërbime të popullit, si policia, FSK, mjekët e kështu me radhë.

znj. Ardita Rrahmani: E drejta ime është me propozuar, kërkoj që të diskutoni me grupet e juaja të përfaqësuara në KK. Ju e keni të drejtën e juaj me votuar apo mos me votuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe unë po themi të drejtën time, mos të iu hymë në hak kategorive tjera që janë në shërbim të popullit.

z. Rrustem Zenuni: Nuk bënë me ardhur situata aty, që pastaj me thënë, që ne deshëm me iu liruar, por ju nuk u pajtuat.

znj. Ardita Rrahmani: Ti e ke të drejtën e plotë në KK me arsyetuar pse jeni, Kundër, Për apo Abstenim. Ju nuk mundeni me ditur qysh votohet çështja në KK, mundet me marrë shumicën e votave dhe me kaluar. Unë jam interesuar për këtë çështje, se ka komuna tjera që i kanë liruar nga këto taksa këto kategori.

Kryesuesi i Kuvendit: Sido që të jetë, ky është propozim. Nëse dikush donë me sfiduar dike politikisht, është e drejtë e secilit.

z. Agim Mani: Të neni 11 që e potencoj Ardita, të kategoritë që lirohen nga këto taksa, të veteranët e luftës dhe invalidët e luftës nuk është bërë për ta. Të veteranët e luftës dhe të invalidët e luftës, shkruan se lirohen nga këto taksa bashkëshortja dhe fëmijët nën moshën 18 vjeçare. Pasuesin e moshës 18 vjeçare duhet me hequr, se kur kërkohet lirimi, kërkohet edhe kartela e valide. Kur e nxjerrë kartelën valide, duhet me marrë ekstraktin familjar, dhe fëmijët që e kanë ndërruar statusin etj., automatikisht hiqen. Fëmijët e këtyre kategorive, shumë pak e gëzojnë këtë të drejtë, sepse janë rritur. Të regjistrimi i automjeteve, është mirë që lirohen veteranët nga taksa komunale, megjithëse unë në dy mbledhje të viteve të kaluara, kam propozuar me i liruar, por nuk janë liruar, për faktin se kërkesa ka ardhur nga ne. Unë e potencova se pak kemi bërë për veteranët dhe invalidët e luftës, sepse edhe ligji është i mangët. Unë si veteran i luftës së UÇK nuk e gëzoj asnjë të drejtë, asnjë benifit nuk e gëzoj. Komuna duhet me u përqendruar këtu, me iu dhënë privilegje. Të regjistrimi i automjeteve, kjo rregullore ka me rënë ndeshë me zbatim, e diskutojmë edhe në KK pse bien ndeshë në zbatim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që kjo çështje të shkoj në KK për trajtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

APROVOJ

Draft-Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa komunale. Kjo draft rregullore i Rekomandohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim-Vendim Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini KK ka të formuar një komision për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, i cili me në fund ka dal me një propozim. Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Desha me pyetur drejtorin: Ku janë bazuar për emërtimin e këtyre rrugëve, në bazë të kërkesave se ku kanë mbërri, apo në bazë të vitit, se pash diku se kërkesat që janë deri me 31 janar 2024.

z. Qamil Stagova: Janë bazuar në bazë të kërkesave të administratorëve dhe qytetarëve.

znj. Kadrije Lika-Troni: A janë marrë për bazë të gjitha kërkesat, se unë e kam një kërkesë këtu, ku kam kërkuar ju me u përgjigju me shkrim në mbledhje, nuk me je përgjigjur. Kërkesa ka qenë edhe rruga qysh me u emëruar. Kjo kërkesë nuk është marrë parasysh. Pse është anashkaluar kjo kërkesë?

z. Qamil Stagova: Unë e di se të jam përgjigjur njëherë në atë kërkesë për punën e rrugës.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse të ka ikur kjo kërkesë, mundesh me pa edhe emrin që e kanë propozuar banorët për me u emëruar rruga. Pse është anashkaluar kjo rrugë, e cila është adresuar që 1 vit në DUKMM? Kërkoj përgjigjen me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit: A i ka shkuar komisionit ajo kërkesë?

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkesa iu ka adresuar DUKMM që një vit, ndërkaq është anashkaluar kjo kërkesë, për faktin se unë jam banuese në atë rrugë.

z. Qamil Stagova: Jo, jo, ne nuk llogarisim asnjëherë në formën se kush jeton në atë rrugë, ndërkaq nëse ju e llogaritni në atë formë, ajo është diçka tjetër.

z. Ramadush Osmani: Një kopje të asaj kërkesë e kam edhe unë. Kjo është deklaratë e komunitetit se heqin dorë nga pronësia për me lëshuar për rrugë, por nuk është format që ia adresuar komisionit për emërtimin e rrugëve, është njëfarë paragrafi që nuk është format i mirë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pse nuk na keni udhëzuar ju që me bërë ne kërkesën të komisioni për emërtimin e rrugëve. Kërkesë me të detajuar, nuk e di a keni pranuar ndonjëherë, se nuk janë banorët e atij niveli që nuk dinë me bërë një kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Për derisa ajo rrugë nuk ka marrë trajtim me qenë rrugë publike, nuk kemi çka diskutojmë për emërtimin e asaj rruge. Njëherë drejtoju që rruga të merr trajtën e rrugës publike.

znj. Kadrije Lika-Troni: Komisioni nuk ka dalë me shikuar fare atë rrugë, kërkesat duhet me u klasifikuar për çka janë. Unë kam me kërkuar qasje në dokumentet zyrtare për krejt kërkesat që janë bërë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju kërkesën e keni bërë me kohë, por derisa nuk e kanë trajtuar ende, për me bërë publike atë rrugë, nuk mund të flasim për emërtimin e asaj rruge.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kjo të bënë me kuptua se komuna nuk është e interesuar me marrë pronën private, për me bërë pronë publike.

z. Qamil Stagova: Unë të kam treguar, se përderisa nuk e asfaltojmë atë rrugë, nuk kam dashur atë pronë private me kaluar në pronë publike, se ata janë të interesuar me ia dhënë komunës atë pronë, për me asfaltuar komuna, bëju reale në këtë drejtim.

znj. Kadrije Lika-Troni: Atë pronë private, ju merri njëherë, pastaj kur ti vjen radha, asfaltohet. Të lutem drejtor, na jepni përgjigjen me shkrim, se ashtu kanë kërkuar komuniteti, sepse sa herë po i ikni kësaj përgjigje. Unë e kam ngritur këtë çështje edhe në seancë të KK, por ju keni qenë jashtë shtetit.

Kryesuesi i Kuvendit: Besoj se drejtori e merr parasysh këtë çështje, me rregulluar në kadastër.

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë këtë çështje kam me zgjidhur, tek e fundit unë kam me qenë ajo që edhe mediat kam me i thirrur për këtë çështje, që komuna nuk është e interesuar me marrë pronën private, për interes publik.

z. Qamil Stagova: Çka ke me bërë në këtë drejtim, keni me shtruar atë rrugë, apo e prisni me shtruar komuna?

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna mundet edhe mos me qenë e interesuar me marrë atë pronë. Në këtë çështje nuk ka punë njëherë komisioni për emërtim të rrugëve. Këtu ka punë DUKMM me dal me skicuar rrugën, me bartë në pronësi të komunës, pastaj me u marrë komisioni me këtë çështje.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkesa e qytetarit duhet të merret parasysh se çka përfshinë dhe mbahet një evidencë për kërkesat. Ka një vit që nuk merret parasysh kjo kërkesë, në neglizhencë të komunës. Me shumën prej 60 mijë euro që janë shpenzuar për rrugë rurale, nuk e dimë cilat rrugë janë shtruar, se nuk na vjen në raport, ka pasur mundësi me u shtruar edhe ajo rrugë.

Kryesuesi i Kuvendit: Se pari duhet bëhet rruga, pastaj emërtimi i saj.

z. Agim Mani: Unë mendoj se nuk janë trajtuar të gjitha rrugët, apo të gjitha kërkesat që kanë qenë për emërtim të rrugëve, ndërrim apo emërim të ri. Është një kërkesë e administratorit të f. Stagovë, qytetarët kanë pasur një kërkesë për ndërrimin e emërimit të rrugës, unë atë emërtim nuk e pashë këtu. Mundet me pasur ndoshta edhe shumë kërkesa tjera që nuk janë trajtuar. E dyta, pyetje për Rustemin, pse nuk ke marrë pjesë direkt në komision për emërtimin e rrugëve?

z. Rustem Zenuni: Me emërimin tim në KPF nuk kam pasur të drejtë të jam në komision dhe kam ofruar dorëheqje, ndërkaq komisioni ka vazhduar me punën.

z. Agim Mani: Si ka pasur mundësi komisioni me vazhduar me punën, pa qenë i kompletuar? Kjo është arsyeja që të bëra pyetjen.

z. Rustem Zenuni: Komisioni është plotësuar edhe me 1 anëtar, ndërkaq ka vazhduar punën, pa anëtarin që është zëvendësuar, për shkak të ligjshmërisë së vendimit.

z. Agim Mani: Duke marrë parasysh faktin se komisioni ka punuar pa një anëtar, pasi që anëtari Fatmir Bujnaku u emërua në mbledhjen e fundit, kërkoj që ky propozim vendim të shtyhet për mbledhjen vijuese. Unë e di kur keni ofruar dorëheqje Rustem. Nëse një anëtar i komisionit ofron dorëheqje, duhet me kompletuar komisionin, ndërkaq pjesëmarrja, kuorumi caktohet në mbledhje. Zëvendësimi i Rustemit është bërë pas 1 viti.

z. Suhad Dullovi: Për atë nuk kanë ardhur emërtimet deri me tani në KK, sepse komisioni nuk ka pasur kuorum. Në momentin që u zëvendësua, është kompletuar komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që janë ndal kompensimet për komisione, po ka problem me funksionuar komisionet. Thirret komisioni, por nuk marrin pjesë.

z. Ramadush Osmani: Komisioni është zëvendësuar, ndërkaq nëse është bërë gabim teknik, që në vend të Fatmirit është shënuar emri i Rustemit, ajo është diçka tjetër.

znj. Ardita Rrahmani: Komisioni duhet me u mbledhë edhe njëherë, që me qenë edhe Fatmiri pjesë e komisionit, pastaj lënda me na ardhur për shqyrtim.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të komisioni, është në përbërje edhe anëtari Rustem Zenuni, i cili ka ofruar dorëheqje.

z. Agim Mani: Unë nuk jam kundër, por për shkak se komisioni nuk ka punuar në përbërje të plotë, kërkoj me shtyrë këtë çështje për mbledhjen vijuese. Të kompletohet komisioni dhe të trajtohen të gjitha kërkesat. A ka komisioni ndonjë procesverbal, që të dimë në çfarë date janë trajtuar këto emërtime dhe pse nuk i ka trajtuar krejt kërkesat?

Kryesuesi i Kuvendit: Çështjet trajtohen në vazhdimësi. Mundet me ndodhë që një rrugë ja merr një ditë, për një emërtim mundem me u mbajtur 2-3 takime me komunitetin, janë shumë problematike këto çështje, se nuk pajtohet komuniteti.

z. Agim Mani: Unë jam për me shtyrë këtë pikë për këto arsye: E para, komisioni nuk është në përbërje të plotë. E dyta, kemi rrugë të paemëtuara, si fjala vjen në Stagovë. Në Stagovë një rrugë e kanë emërtuar, por në ndërkohë e kanë hequr atë emërtim.

z. Qamil Stagova: Ka edhe rrugë tjera që nuk janë shqyrtuar. Tani janë zgjedhjet lokale, nuk mundemi me marrë vendim 6 muaj para zgjedhje lokale. Nëse nuk shpallen zgjedhjet lokale, munden me u shqyrtuar kërkesat dhe me u proceduar për mbledhjen vijuese. Ndërkaq nëse shpallën zgjedhjet lokale, për këtë mandat ka përfunduar kjo çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështjet Nëse e shtyjme këtë çështje, në 6 muajt e fundit para zgjedhjeve, nuk kemi të drejtë me emërtuar rrugë. E dyta, të përbërja e komisionit, është gabim teknik, se Fatmir Bunjaku ka marrë pjesë në mbledhje të komisionit qysh e di unë, kështu në KK vjen lënda me nënshkrim të Fatmirit.

Nënkryetari i Komunës: Ka rrugë që janë të paemëtuara, por duke ditur se nuk ka pasur kuorum në disa takime, kur janë mbledhë komisioni, i kanë trajtuar ato kërkesa që i kanë pasur. Agim, a je duke dyshuar që në këtë mbledhje ka marrë pjesë anëtari Fatmir Bunjaku, pa qenë ligjshmëria, apo çka është në pyetje. Në takimin e komisionit nuk ka marrë pjesë Fatmiri, se nuk ka pa ardhur ende ligjshmëri. Me 4 anëtarë të komisionit është vendosur, pasi që ka pasur kuorum.

z. Agim Mani: Në njërën anë, ne e kemi votuar dorëheqjen e Rustem Zenunit nga komisioni për emërtimin e rrugëve, në anën tjetër e ka emrin në Propozim Vendim. Komisioni nuk ka pasur përbërje të plotë, me 4 anëtarë komisioni është jofunksional.

Kryesuesi i Kuvendit: Secili komision që ka kuorum, është funksional.

z. Agim Mani: Duhet me u emërtuar krejt rrugët, se unë e di në f. Stagovë, atë ditë që janë vendosur emërtimet e rrugëve, një rrugë ia kanë hequr emërtimin, sepse nuk janë konsultuar me komunitetin. Kjo çështje është para 5-6 viteve. Kur ka kërkesa për emërtim të rrugëve, unë nuk e di cila është arsyeja me pritur tutje.

Kryesuesi i Kuvendit: Zyrtare janë vendimet që i merr KK për emërtimin e rrugëve. Nganjëherë munden mos me i pëlqyer dikujt, por çështja është, çdo shkelje e atij vendimi, është vepër penale.

z. Agim Mani: Pse nuk janë marrë organet me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë organet që merren me atë çështje, pasi që në momentin që një vendim votohet në KK, bëhet i plotfuqishëm. Vepër penale është shkelja e atij vendimi, nga kushdo qoftë.

z. Agim Mani: Nëse ka marrë vendim KK që përbërja e komisionit me qenë prej 5 anëtarëve, atëherë pse nuk e ka komisioni këtë përbërje?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është sepse, një anëtarë ka ofruar dorëheqje dhe i njëjti është zëvendësuar.

z. Agim Mani: Unë nëse e votoj këtë vendim, ndërkaq kërkesa e Stagovës nuk është e përfshirë, kjo nuk është në rregull. Duhet me qenë serioz, se nuk janë trajtuar të gjitha rrugët.

z. Qamil Stagova: Të neni 2 i Propozim vendimit, është fjala për vendbanimi me nr. 5 është propozuar rruga me pasur emrin "Bamirësia", rrugë kjo që përshkon dy fshatra, Kovaçec dhe Biçec, por kanë lindur disa mosmarrëveshje, kështu që këtë emërtim propozoj me tërhequr derisa të merren vesh.

Kryesuesi i Kuvendit: E qartë.

z. Rrustem Zenuni: Unë sa kam qenë anëtar i komisionit, kam pasur në propozim për Duraj, një degëzim të rrugës "Ahmet Kaçiku". Nuk e di pse e kanë tërhequr komisioni atë emërtim. Propozimi nuk u ka qenë selektiv, kemi dashur me pasur emra pak me të vjetër, duke ditur të kaluarën e këtij vendi.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika e parë, këtë praktikë vet e kemi mbjellë për me qenë tani të pakënaqur, përfshirë edhe vetën time. Ne kemi lejuar që rrugët me u emërtuar në emër të gjyshërve dhe babagjyshërve, që njerëzit sot me qenë të pakënaqur. Kjo nuk duhet me ekzistuar. Është UA, janë kriteret që përcaktojnë saktë emërtimet e rrugëve. Rruga që emërtohet me një emër, ai emër duhet me pasur një histori, një kontribut, një biografi, jo vetëm me vendosur një emërtim të gjyshit të dikujt, duhet dita ditës me larguar këtë praktikë. Komisioni fillimisht i ka kontaktuar administratorët e lagjeve urbane dhe të fshatrave, administratorët janë konsultuar me këshillat e fshatrave, nuk kemi mekanizëm tjetër ne. Me filluar me pyetur shtëpi për shtëpi, nuk mundem me arritur asnjëherë me i emërtuar rrugët. Në atë kohë, për Doganaj, nuk ka pasur asnjë problem as atëherë e as tani, se kriter në fshat ka qenë me u përfshirë dëshmorët. Janë përfshirë të gjithë dëshmorët në rrugët me kryesore. Martirët që kanë rënë në luftë, janë përfshirë, ndërkaq rrugët që kanë mbetur, janë emërtuar me emra historik, ose me data historike. Ndërsa fshatrat e lagjet të cilat kanë vendosur me emërtuar rrugë në emër të gjyshërve etj., na kanë shkaktuar probleme të mëdha. Kështu ka ndodhur edhe në f. Stagovë dhe në lokalitete tjera. Tani të mundohemi t'i riparojmë ato gabime që i kemi bërë në të kaluarën, përfshirë edhe vetën time. Ju edhe ne si anëtarë të KK kemi mundur me qenë të painformuar se cili ka qenë komunikimi i administratorëve me komisionin, ndoshta propozimi ka qenë krejt tjetër, e që ne këtu na duket jo në rregull. Është mirë me u konsultuar me administratorët secili nga ne, dhe me shikuar se cilët kanë qenë propozimet e tyre për emërtimet e rrugëve, se propozimet nuk janë dhënë nga komisioni, por janë me propozime të lokaliteteve. Ka propozime e kërkesa shumë, mundet mos me u përfshirë ndonjë prej kërkesave, fokusohemi në këto që i kemi, në të ardhmen sigurisht se kemi me

pasur edhe propozim tjera. Të fokusohemi në çështje konkrete, në propozime konkrete, e jo në çështje të komisionit se a është legjitim apo jo, për këtë vendosë ministria. Pastaj a duhet me u zbatua dhe me u ruajtur këto emërtime. Unë jam i mendimit që kudo që ka mospajtime, mos me i trajtuar ato emërtime, deri sa të arrihet pajtimi, ndërkaq kur të emërtohet një rrugë, jam i mendimit që ai emërtim mos të prekët më. Nuk duhet me u mësuar askush me thyer një vendim të KK, edhe ligji e thotë, se është vepër penale nëse thyhet një vendim i KK. Për këtë arsye po themi, se duhet me pasur kujdes edhe ne, që një vendim që merret, mos të detyrojmë nesër dike me shkelë atë vendim, se me këto probleme ka me u marrë kushdo që vjen edhe pas neve, për atë punë jemi këtu, me u përballë me probleme që na kanë votuar qytetarët.

z. Rustem Zenuni: Kërkesën që nuk e ka përfshirë komisioni, emërtimin e degëzimit të rrugës në Duraj me i rekomanduar drejtorit, që me u përfshirë kjo rrugë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Adresojë kërkesën me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit: Për këtë mbledhje ka përfunduar, komisioni e ka përfunduar punën e vet.

z. Rustem Zenuni: Për një rrugë, u vendos me u hequr. A e shqyrton komisioni atë rrugë me hequr? Lë të trajton komisioni pra tërheqjen e asaj rruge. Ne ia adresojmë KK. KK lë të trajton. Në momentin që një zyrtar nuk i bindet urdhrave të eprorit, ndaj atij zyrtari merren masa.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk ka ndryshim aty, veç tërhiqet ajo rrugë. Mos u merr me tema tjera.

z. Rustem Zenuni: Gabim është.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është gabim.

z. Agim Mani: Unë propozoj të lihen për mbledhjen vijuese emërtimet e rrugëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundemi me shtyrë për mbledhjen vijuese, për shkak se nuk kemi të drejtë me marrë vendime të kësaj natyre së paku 6 muaj para zgjedhjeve.

znj. Kadrije Lika-Troni: Theksoj se për rrugën: UÇK, krejt dokumentet i kemi rregulluar me emërtim të kësaj rruge, ndërkaq në tabela të emërtimit, kjo rrugë është e regjistruar rruga: “Izahir Troni” pjesa e cila fillon nga Trupajt deri të Nikajt.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t’i shkoj KK, me ndryshimin që rruga “Bamirësia “ në f. Biçec të hiqet? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim-Vendim Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 4 (tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 29.04.2025 (e martë) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik



Nr. 06-350/02-10934/25

Datë 16.05.2025

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të neni 6 pika 2 shkronja (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës të merre këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELES KADASTRALE 00515-1 NË ZK,
KAÇANIK,

- I. Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për shpallje të parcelës me interes publik të pronës së paluajtshme në ZK Kaçanik me pronësi private të personit fizik
- II. Sipas propozimit të cekur në piken -I- të këtij propozimi, lidhje me shpalljen e interes publik të parcelës të pronës si vijon:
 1. Parcela Kadastrale P-70917048-00515-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 9958 m^2$, në pronësi NASA HOLDING SH.P.K. me pronar Liridon Palloshi, me vendodhje Rr " Ismail Raka", ZK Kaçanik (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $1782.73 m^2$, e cila nevojitet për Vazhdimin e rrugës " Rr " Ismail Raka", me Lagjen e Re deri te Lumi Nerodime, sipas projektit për lidhjen e rruges).

Arsyetim

Propozimi për iniciimin të Kërkesës për shpallje të parcelës me interes publik të parcelës nr P-70917048-00515-1, në ZK. Kaçanik me pronësi private u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për Lidhjen e rrugës Rr " Ismail Raka", me Lagjen e Re deri te Lumi Nerodime sipas projektit për lidhjen e rruges DUKMM-ja duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke marrë parasysh interesin publik për realizimit të këtij projekti për Lidhjen e rrugës " Rr " Ismail Raka", me Lagjen e Re, e cila ka karakter të interesit publik, pas miratimit të këtij propozim Vendimi nga ana e Kuvendit Komunal do të filloj procedura e Shpronsimit për pasurin e paluajtshme të theksuar më lartë.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi Të bashkangjitur gjeni dokumentet si më poshtë:

- Situacioni i terrenit,
- Kopja e planit,
- Certifikata e pronës.

Drejtori I DUKMM-së
z. Qamil Stagova

Kryetari I Komunës
z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-00515-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 06-942/02-0010923/25

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 15.05.2025 - 14:24

Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik / Kačanik / Kačanik

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917048-00515-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	9958	70-2009, 1-2017	06.02.2017	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
TE MULLINI			06.02.2017	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Tokë Tjetër Ostalo Zemljište Other Land	Shpellë/Pecina alcove		9958

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseđim individual Individualna Drzavina Single possessor	NASA HOLDING SH.P.K.	811383034	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /		Rrugë Rexhep Bishimi, pn	1/1	436/2025 Kontrata per Nderitim te Perbashket LRP nr. 255/2025 Ref.nr.81/2025 dt 08.05.2025	13.05.2025




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KACANIK
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone. Kaçanik

10923/25

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917048-00515-1	Parcelë / Parcela / Parcel	9958



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1768

Punoi/Obradio/Created: Mentor Shehu
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 15.05.2025
Koha/ Vreme/ Time: 02:25:49

SITUACIONI I TERENIT

Zyra kadastrale kmunale / Opštinska katastarska kancelarija: Kaçanik

Zona kadastrale / Katastarska zona: Kaçanik

Nr. i njesisë kadastrale / Br. katastarské jedinice : 515-1

Numri i lëndës / Broj predmeta:

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1500


Lista e koordinatave të pikave të matura:

Lista e koordinatave të rrugës e cila do ti bartet
si rrugë Komunës së Kaçanikut S=1782.73m²

1	7521016.957	4677647.512
2	7521018.090	4677651.214
3	7521019.703	4677659.632
4	7521025.556	4677674.033
5	7521028.608	4677705.703
6	7521031.958	4677739.338
7	7521031.112	4677739.878
8	7521024.400	4677744.171
9	7521020.646	4677706.483
10	7521017.705	4677675.963
11	7521011.995	4677661.913
12	7521010.314	4677653.143
13	7521009.124	4677649.254
14	7521000.412	4677587.724
15	7521000.241	4677545.865
16	7521002.293	4677521.158
17	7521010.283	4677521.614
18	7521008.242	4677546.180
19	7521008.410	4677587.144

Shpjegues:

Në këtë skicë është paraqitur rruga me sipërfaqe prej S=1782.73m², e cila është pjesë e parcelës me nr 00515-1 zk Kaçanik, ku do ti bartet Komunës së Kaçanikut.



Rilevoi / Snimio: (emri, mbiemri i gjedeti/kompanisë/ imë, prezime gjeodeta/ kompanije)

Data e rilevimit / Datum snimanja:

Nënshkrimi / Potpis:

SITUACIONI I TERENIT

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: _____ Kaçanik
Zona kadastrale / Katastarska zona: _____ Kaçanik
Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarské jedinice : 515-1, 1846-1, 186-2, 1848-0
Numri i lëndës / Broj predmeta: _____
Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 5000
Lista e koordinatave të pikave të matura:



Shpjegues:

Në këtë skicë është paraqitur lidhja e rrugëve egzistuese dhe asaj të propozuar e cila do të bartet Komunes së Kaçanikut

Rrugë egzistuese

Rruga e propozuar

Rilevoi / Snimio: (emri, mbiemri i gjeodeti/kompanisë/ imë, prezime gjeodeta/ kompanije)
Data e rilevimit / Datum snimanja: 13/05/2025
Nënshkrimi / Potpis: _____